



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **84**

Prishtinë, më 4.9.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Mungoi : Daut Haradinaj, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Ministri dhe zyrtar nga MBPZHR si dhe tjerët të ftuar të zakonshëm.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 31.8.2012,
3. Shqyrtimi i gjendjes në pyjet e Kosovës, me ministrin e bujqësisë,
4. Dy projektligjet për leximet e para,
5. Dy projektligjet për leximet e dyta,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 31.8.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 31.8.2012.

3. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës 4,5,6

Kryetari i Komisionit sugjeroi shqyrtimin e pikave të rendit të ditës në ndërkohë derisa arriti ministri i bujqësisë, ndaj komisioni në vazhdim shqyrtoi dhe vendosi :

- u rekomandua leximi i parë për Projektligjet për Ujërat e Kosovës dhe Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale,
- u rekomandua leximi dytë për Projektligjin për Bujqësinë Organike dhe Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me amendamentet e propozuara nga Komisioni, dhe me kërkesën e **Afërdita Berishës** dhe **Nijazi Idrizit** për një vizitë në Hungari, ashtu si është kërkuar nga komisioni paraprakisht rreth përvojave të zbatueshmërisë së Ligjit për bimët organike (**Kryetari i Komisionit** rikujtoi se kjo vizitë varet nga ajo se a do të miratohet nga projekti i binjakëzimit me Kuvendin e Kosovës ku bënë pjesë edhe Hungaria si kryesuese e projektit),
- **Nijazi Idrizi** potencoi se **së pari duhet të ekzistojnë kadastra e ujërave pastaj të hartohet strategjia i shfrytëzimit shumëqëllimor të ujërave, në fund të hartohet Ligji për Ujërat dhe Ligji për Ujitje me Ligjet tjera që kanë të bëjnë me ujërat, dhe kështu Ligjet bëhen të zbatueshme dhe jetëgjata.**

Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari i Komisionit potencoi :

- Kërkesën e ZRRUM për të bërë ndryshimet e duhura ligjore pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbeturina , i cili heq kompetencat e ZRRUM sa i përket mbeturinave. Komisioni u pajtua që kjo kërkesë të shqyrtohet pasi të miratohet në Kuvend Projektligji për Ujëra,
- Sa i përket ekspertëve që duhet të emërohen rreth Projektligjeve në procedurë, Kryetari prezantoi CV për tre ekspertë, ndaj Komisioni nxori :

V E N D I M

- I. Elez Krasniqi**, angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth Projektligjit për Mbrojtjen e Bimëve.
 - II. Arben Mehmeti**, angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth Projektligjit për Mbrojtjen e Bimëve.
 - III. Seid Abazi**, angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth Projektligjit për Rexhistrimin e Bujqësisë, ndërsa eksperti i dytë për këtë Projektligj do të emërohet në mbledhjen e radhës.
Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i komisionit dhe NDI që brenda dy ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definojnë përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.
- Komisioni të drejtohet me shkrim Ministrisë së Bujqësisë rreth angazhimit të hartimit të Ligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht, i cili Projektligj nga Kuvendi është kthyer Qeverisë për të kompletuar sipas kërkesës së ekspertit përkatës të lëmisë.

Raporti i Ministrit Blerand Stavileci rreth djegëjes së pyjeve në Kosovë

Kryetari i Komisionit falënderoi për pjesëmarrjen e Ministrit dhe Kryeshefit të APK të cilët i njoftoi me kërkesën e komisionit për njoftim më detal rreth zjarreve në pyjet e Kosovës duke njoftuar fillimisht me shkresën nga MPB ku vërtetohet angazhimi maksimal i kësaj Ministrie. Megjithatë Kryetari pyeti Ministrin në fillim pse ndodhën këto dëme me përmasa kaq të larta.

Ministri z. Stavileci fillimisht kërkoi falje për vonesë dhe vazhdoi me sqarimin e kërkuar duke shtuar se në djegëjen e pyjeve kanë ndikuar një mori faktorësh, fatmirësisht pa pasoja në sigurinë e qytetarëve dhe puntorëve të angazhuar më këtë rast. MB është e dëmtuar më së tepërmi me këto zjarre në pyje, vazhdoi, mirëpo ai falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e angazhuar në shuarjen e zjarreve, sidomos në Koritnik ku janë rrezikuar edhe jetërat e zyrtarëve të Ministrisë (këtu janë djegur 600 ha pyje kualitative). Përkundër intervenimeve të vështira në terren të vështirë, gjatë këtyre përpjekjeve është pa qartë mungesa e pajisjeve të duhura teknike të institucioneve vendore, potencoi ai. Rekomandimet e Komisionit i mbështeti plotësisht, sidomos kërkesën e parashtruar për zyrën e KE në Prishtinë. Pasi që në ditët në vijim do të pasojë zvogëlimi i temperaturave, ai shprejtoj se së shpejti do të shuhen edhe 15 vatra të mbetura të zjarreve që vazhdojnë ende anekënd në Kosovë (sipas njoftimit të Kryeshefit të APK z. Zejnullahu), mirëpo ai apeloj për unitet të plotë të të gjithë institucioneve relevante në mënyrë që dëme të tilla në vitin vijues mos të ndodhë, por edhe në të ardhmen. Edhe pse ai nuk dëshoi të gjej fajtorin kryesor, theksoi se Komunitat kanë marr kompetencat ligjore për mbrojtjen e pyjeve që nga viti 2010, por siç theksoi më lartë, është pa qartë mungesa e pajisjeve të duhura teknike. **Kryeshefi i APK z. Zejnullahu** njoftoi se momentalisht janë duke u djegur 3400 ha, prej tyre 2900 ha pronë shoqërore, halor 800 ha, ku më të prekur janë sipërfaqet në rajonin e Prizrenit dhe Pejës. Dëme më të pakta ka Ferizaj. Vlerësimi i dëmit do të pasojë në ditët vijuese sipas planit të caktuar (pyetje nga **Rasim Demiri**), nëse parashtrohet pyetja a kemi mundur më tepër, ai tha se kapacitetet vendore nuk janë as përafërmi të mjaftueshme për situata të tilla. Sipas tij pjesa më e madhe e maleve janë djegur nga pakujdesia por organet kompetente këtë do të vërtetojnë në ditët vijuese.

Kryetari i Komisionit hapi debatin dhe pyeti Ministrin a mjafton ky angazhim i institucionit tonë kryesor me rastin e shkaktimit të kësaj zjarre pasi që dëmi është tejte i lart, a duhet të ndahen kompetencat tani pasi që edhe Ligji për Pyje është miratuar në Qeveri, pse nuk është mbajtur menjëherë në fillim mbledhje urgjente të krerëve kryesor, pse nuk janë parashtruar kërkesat për KFOR etj. Ministri potencoi se nuk mund të jap përgjegje për dy Komunitat ku ka djegëje më së tepërmi (Dragashi dhe Deçani) ku këto djegëje nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, për shkak të përgjegjësisë ekskluzive të komunave të përcaktuara sipas ligjit, por megjithatë APK në çdo moment ka qëndruar bashkë me Komunitat. Ai nuk u prononcua se a duhet të ndahen kompetencat por apeloj për unitet. Pasi që **Kryetari** njoftoi për diskutimet e komisionit me kryetarin e Komunitës në Deçan, Ahmet Zejnullahu tha se më 26 qershor në Deçan janë ndaluar tenderët e prerjeve të drunjve dhe u pajtua se operatorët duhet të ndëshkohen.

Liburn Aliu : U dakordua se për djegëjen e pyjeve duhet të jemi bashkë. Ky komision e ka dëshmuar këtë, që nga fillimi i korrikut kur janë vërejt vatrë e para të zjarrit në Deçan, me vizitat që janë bërë. Nuk më pëlqen, vazhdoi ai, ikja nga përgjegjësia e ministrit dhe shefit të APK-se kur thonë se mbrojtja është kompetencë e komunave. APK e ka për detyrë monitorimin dhe do të duhej të monitoronte se a janë marrë masat parandaluese. Zjarri në Koritnik ka ardhur nga R. e Shqipërisë dhe atje zjarret kanë filluar që nga 6 gusht dhe në Kosovë kanë depertuar me 21 gusht, pra ka pasë 15 ditë kohë për parandalim. Poashtu ministria ka mundur ta senzibilizojë Kryeministrin dhe Emergjencat për parandalim pasi bëhej fjalë për pyllin më cilësor që kemi. Komunitat nuk kanë mundur të përballen pasi i kanë kapacitetet e vogla. Komuna e Sharrit nuk mund të përballë me djegëjet me 14 zjarrëfikës që ka dhe të cilës ia ka marrë ministria.

Fakti që janë gjetë keqpërdorime nga operatorët në Deçan, të cilët kanë bërë prerje në pyjet e djegura, tregon se motivi i djegëjes për tendere ekziston. Bëhet djegëja dhe vitin tjetër për atë zonë shpallet tender i pastrimit. Pra ekziston bazë për dyshime për lidhjen në mes të tenderëve dhe djegëjes. Ai gjithashtu theksoi se nuk ka viktima në njerëz, por ka katastrofë.

Ministri sërish kërkoi unitet ngase duhet të krijohet një sistem i veçantë i mbrojtjes në formën më të mirë, e jo të hedhim përgjegjësinë tek njëri tjetri dhe të japim rekomandime për të ardhmen. **Ahmet Zejnullahu** pohoi se tendera ka pasur edhe në Koritnik dhe se APK ka ditur për zjarrin e 6 gushtit, mirëpo sipas tij çështja është se kompetencat në kufi janë të shpëputura, gjithashtu sipas tij më 23 gusht është kërkuar intervenimi i FSK, me të cilin rast është konstatuar

se ka pasur edhe vende të minuara, pra APK ka kryer të gjitha obligimet që i kanë takuar, përndryshe dëmet do të ishin shumë më të mëdha, përfundoi ai.

Liburn Aliu nuk mohoi se ka pasur tendera edhe në Koritnik por jo sa në Deçan, dhe tha : “nëse keni ndërmar veprimet për të intervenuar më shpejt, çdo gjë në rregull, por ju keni mundur të kërkonti ndihmën edhe nga zyra e KE në Prishtinë nga mekanizmi i komitetit për mbrojtje civile, i cili nga viti 2007 ka intervenuar në shumë raste në Evropë”.

Afërdita Berisha pyeti pse sistemi i kërkuar nga ministri nuk është funksionalizua më heret, kur dihet se edhe më 2007 ka pasur zjarre. Ministri reagoi dhe tha se shumë arsyera janë, njëra është mungesa e regjistrimit të bujqësisë dhe shumë tjera arsyera, pos asaj ka zona ku depërtohet shumë vështirë. Znj. Berisha vazhdoi dhe tha se ministria ka pasur kohë për të intervenua, në anën tjetër tenderët po funksionojnë, konstatoi ajo. Ndërhyri **Kryetari** dhe japi sqarim për ministrin ngase me rastin e vizitave në Gjakovë dhe në Pejë janë parashtruar kërkesat për blerjen e helikopterit etj si dhe është bërë e njohur që ekzistojnë agjencionet që japin me qera avionët. Ministri përsëriti kërkesën për sistemin e cekur ngase përvoja nga terreni kërkon këtë.

Nijazi Idrizi shfaqti shqetësimin mos po ndodhin këto gjëra prapë në vitin vijues dhe përgëzoi fshatrat Lubisht, Ranilluk ku fshatarët ia kanë dalë me forcat vetanake. Ai konstatoi se gabimi ynë qëndron kur marim vendime të mëdha, ngase nuk mendojmë se a mund të realizohen, siç është rasti tani me Komunitet të cilat si duket nuk ia dalin në luftë për mbrojtjen e pyjeve. Ai kërkonte që të hartohen planet për mbrojtjen nga zjarri, të vlerësohen dëmet, të shihet çka nuk ka funksionuar, të vlerësohet infrastruktura e përgjithshme se a ka nevojë të riparohet apo të ndërtohen rrugët e reja, të krijohen brezat e ndarjes së pyjeve, apo të mbillen bimë që nuk digjën lehtë etj , me një fjalë vendimet që mirën të kanë jetëgjatësinë e vetë.

Sevdije Lama pyeti pse nuk janë përgjigjur forcat e KFOR-it dhe a duhet marrëveshje institucionale me ata, si dhe kërkonte krijimin e task forcës me krerët institucional, gjithashtu pyeti për bimët endemike a do të mbeten jashta parkut kombëtar të propozuar.

Behxhet Mustafa nga Bordi i Mjedisit kundërshtoi ashpër zyrtarët prezent nga APK ngase si konstatoi ai, tani që është propozuar sipërfaqja shumë e vlefshme Koritniku për park kombëtar, ndodhi zjarri, ndërsa në anën tjetër dihet se APK ka kundërshtuar shpalljen e këtij parku, atëherë si mos të dyshohet në këtë neglizhencë, ngase popullata fiton nëse shpallet parku, “diku po i konvenon ende të vonohemi me shpalljen e parqeve nacionale” konstatoi ai, ndaj apeloi që sa më shpejt komisioni të përfundoi projektligjet dhe të shpallen dy parqet nacionale ashtu si janë tani, edhe pse janë të djegura në një masë.

Nijazi Idrizi : po profesor, por fjala është për djegëje të pyjeve.

Behxhet Mustafa : po kuptoj, por nuk duhet ti fryhet zjarrit.

Ministri : MMPH mund të emërtoj si të doni, por asgjë nuk do ti shpëtonte zjarrit. Po themi se ka dyshim të bazuar për lidhjen e zjarrit me tendere, por atëherë ku janë Komunitet tjera. Fakti se telefonat ishin të mbyllura flet mjaft.

Liburn Aliu mbetem tek qëndrimi se tenderët mund të kanë lidhje me zjarre.

Nijazi Idrizi : pse Ferizaji nuk ka zjarre.

Ahmet Zejnullahu kundërshtoi Behxhet Mustafën ngase APK ka kundërshtuar parkun Bjeshkët e Nemuna në formën si është propozuar, por jo më tepër. Ai konstatoi se akuzat duhet të drejtohen në kahjen tjetër, assesi tek APK.

Behxhet Mustafa tha se akuzat i ka drejtuar qysh para 6-7 vitesh në kohën kur nuk kanë qenë zyrtarët e sotëm, dhe qëllimi i tij ishte se të bardhës duhet ti thuhet bardhë, e të ziut , e zezë.

Kryetari i Komisionit sa për ilustrim tha se tani është kthyer nga Sllovenia ku gjatë kësaj kohe shumë të nxehtë nuk ka ndodhur asnjë zjarr i vetëm nëpër pyjet e tyre. Në fund kërkonte raportet me shkrim si nga APK ashtu edhe nga Bordi i Mjedisit, për të dalur me një qëndrim të qartë në mbledhjen plenare të radhës, por pas përmbylljes së pavarësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 15,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani

